

Bekim Fehmiu në vetën e parë - vështrim gjuhësor i librit "E shkëlqyeshme dhe e tmerrshme"

Haki Hysenaj

26 gusht 2012

Përmbledhje

Përzgjedhja e kësaj kumtese, në radhë të parë, ndërlidhet me interesimin tonë për të parë gjuhën e autorit dhe ndërtimin e tekstit, ngase **Bekim Fehmiu**, pas vdekjes, po i prezantohej publikut shqiptar edhe me një formë të veçantë komunikimi, me të cilin nuk ishim mësuar për të gjallë të tij.

1 Hyrje

Botimi shqip i librit "*E shkëlqyeshme dhe e tmerrshme*" i aktorit me famë botërore, **Bekim Fehmiu**, vitin që shkoi në letrat shqipe u shënua si një ngjarje e veçantë kulturore. Ndonëse i gjendur midis komenteve të ndryshme, jo për vlerat artistike e gjuhësore, libri "*E shkëlqyeshme dhe e tmerrshme*" megjithatë krijoi raporte shumë të shpejta komunikimi me audiencën.

Kureshtja për rrëfimin autentik të shkruar të një aktori shqiptar, i cili gjithë krijimtarinë e vet e realizoi deri në përmasat e botërores në një vend jo shumë të këndshëm për shqiptarët, mbase qe motivi kryesor për këtë interesim. Mirëpo, kjo nuk është arsyeja e përzgjedhjes së këtij libri për këtë kumtesë. Përzgjedhja, në radhë të parë, ndërlidhet me interesimin tonë për të parë gjuhën e autorit dhe ndërtimin e tekstit, ngase Bekim Fehmiu, pas vdekjes, po i prezantohej publikut shqiptar edhe me një formë të veçantë komunikimi, me të cilin nuk ishim mësuar për të gjallë të tij. Libri "*E shkëlqyeshme dhe e tmerrshme*" nuk do mend se anon nga kujtimet e shkruara, por brenda tij nuk mungon gjuha figurative, leksiku relativisht i pasur dhe ndër të veçantat e tjera edhe një fjalës karakteristik "i ligjërimit urban", shpesh i përzier me fjalë e shprehje orientale, të cilat në diskursin e tij shpesh mbartin ngarkesë të caktuar emocionale.

Këto njësi dhe të tjera, që do të përmenden në vazhdim, të vënë para dilemës nëse libri "*E shkëlqyeshme dhe e tmerrshme*" është një tekst letrar ose jo. Gjuha e këtij teksti nuk është vetëm e karakterit denotativ, siç del në tekstin gjuhësor dhe në gjuhën e kujtimeve të shkruara. Në shumë sekuenca rrëfimesh, të cilat pahetueshëm krijojnë koherencë përmes

njësish gramatikore e leksikore, ajo merr edhe karakter konotativ, d.m.th. rrëshqet në forcë shprehëse. Ky ndërrim kodit shpesh kushtëzohet nga ngjarjet e rrëfyera, situatat dhe vetë konteksti.

Shkrimi në vetën e parë, përdorimi i vetës së tij si personazh kryesor, dendësia përdoruese e kohës së tashme dhe e kohës së kryer të dëftores e më pak edhe e kohës së ardhme të po kësaj mënyre si kohë komenti, pastaj frekuenca e madhe përdoruese edhe e kohëve të rrëfimit, përdorimi i fjalive të shkurtra, gati gjithnjë të paraprirra nga fjalitë lajmëruese që përcillen nga fjali rrëfyese, si dhe leksiku arkaik i një gjuhe urbane janë ndër specifikat kryesore të ligjërit individual të këtij autori.

Trajtesa jonë përqendrohet në hulumtimin e elementeve të shënuara më sipër. Vështrimi është vetëm gjuhësor dhe assesi nuk lidhet me interpretime të tjera jashtëgjuhësore.

2 Sfondi

"E shkëlqyeshme dhe e tmerrshme" është libri i vetëm i këtij autori. Bekim Fehmiu e ka botuar librin "E shkëlqyeshme dhe e tmerrshme" në vitin 2001, ndonëse e ka shkruar që më parë, ndonjë version të tij qysh në vitet tetëdhjetë (Rugova, 2011: 9-11). Sipas parathënies, autori e kishte shkruar librin e tij "E shkëlqyeshme dhe e tmerrshme" në gjuhën shqipe fillimisht dhe, pastaj, pas një konsultimi me miqtë, kishte vendosur ta përkthente në serbishte dhe ta botonte, së pari, për opinionin serb (Rugova, ibid.:2011 (te gjendet citati) po aty). Teksti i këtij libri shtrihet në 285 faqe dhe përmbledh kujtimet kryesore të autorit për kohën e adoleshencës së tij. Kujtimet e rrëfyera në vetën e parë në tekst janë të ndara në formë sekuencash, por "loja me gjuhën", përdorimi i mjeteve kohezive, si dhe dinamika e tekstit krijojnë një tërësi tekstore, që jep mundësinë e hulumtimit në rrafsh të ndryshme.

3 Individualiteti gjuhësor dhe shkrimi personal

Siç u tha edhe më lart, rrëfimi në vetën e parë, realizimi i tekstit kryesisht në kohën e tashme të dëftores, përdorimi i fjalive të shkurtra dhe "loja" me leksikon krijojnë individualitet gjuhësor të këtij autori. Nga ana tjetër, shkrimi personal dhe rrëfimi i rrjedhshëm janë attribute të tjera që kompletojnë edhe më shumë këtë konstatimin. Megjithatë, komponenti i fundit, d.m.th. shkrimi personal shpesh tejkalon kufijtë subjektivë. Rrëfimi "i copëzuar" transformohet në rrëfim impersonal, dhe si i tillë shpreh jo vetëm fatin e familjes së autorit, por edhe fatin e etnitetit të tij. Kështu "E shkëlqyeshme dhe e tmerrshme" sa mund të cilësohet si rrëfim personal, aq mund të cilësohet edhe si rrëfim impersonal. Hamiti thotë se "Krijimi individual shpie gjithmonë kah origjinaliteti, që do të thotë kah universaliteti, duke kaluar nëpër procesin e papërsëritshëm të personalizimit. Personalizimi është e kundërta e tjetërsimit, ai është një proces i identifikimit" (Hamiti, 2000:34). Autori, duke ndërtuar tekstin e tij kryesisht në vetën e parë, krijon këtë individualitet autorial. Prandaj themi se Bekim Fehmiu me këtë libër prezanton individualitet krijues në rrafshin gjuhësor. Është diskursi i tij ligjërimit, përshkrues e narrativ, i realizuar në këtë vetë gramatikore, që gjuhën e stilit të tij i bën të veçantë. Në të gjitha tregimet autori nuk

fshihet. Identifikohet gjithnjë me këtë vetë, si në rastin e botës së evokuar, ashtu edhe në rastin e tregimit. Edhe kur evokon ngjarje në formë rrëfimi, ndihet prania e tij. Madje, veta e tij edhe në këtë formë shkrimi del në rolin e personazhit kryesor, çka do të thotë se autori gjithnjë ndodhet në epiqendër të vëmendjes e të rrëfimit, jo vetëm në pozita neutrale, por edhe vepruese. Sekuencat rrëfimore të këtij libri flasin për përcaktimin e autorit për të rrëfyer ngjarjet e përjetuara si të vërteta e fat kolektiviteti, e jo për të shfaqur vetëm vetën e tij. Pra, përdorimi i vetës së parë dhe i kohës së tashme, si kohë rrëfimi, janë dy nga specifikat kryesore të këtij libri. Nga ana tjetër "E mrekullueshme dhe e tmerrshme" i autorit Bekim Fehmiu shquhet edhe për transformime diskursesh. Transformimet nga një tip në tjetrin dhe shpesh edhe gërshetimi i tyre brenda një rrëfimi me prirje të shtrirjes vertikale, ligjërimin e tij e bën specifik. (Shih tregimin: "Familja ime" f. 34-40). Smith identifikon 5 lloje diskursesh: diskursin narrativ, raportues, përshkrues, informativ dhe argumentues (Smith, 2003:1). "E shkëlqyeshme dhe e tmerrshme" shquhet për diskursin përshkrues dhe narrativ, ndërsa 3 të tjerët mund të hetohen me një analizë më të përimtuar. Ligjërimi përshkrues dominon në tekst, ndërkohë gërshetimi me diskursin narrativ rrëfyesin e bën të mos jetë neutral ndaj atyre që thotë. Këtë formë ligjërimi Hamiti e quan bashkëkohor dhe joneutral (shih: Hamiti, ibid,: 2000:45).

Ndërsa Fuko thekson se një tekst letrar mund të nxisë njëkohësisht diskurse jashtëzakonisht të ndryshme. Duke u mbështetur në analizën psikologjike, diskursin e interpreton si objekt të dëshiruar, si mundësi që duhet të përfitohet (Fuko, 2007:20). E kjo duket e arrirë në tekstin e Fehmiut, ani pse diskursi përshkrues zë vend qendror. Ngjarjet në libër rrëfohen në mënyrë kronologjike, duke filluar nga Kujtimi i parë-përjetimi i parë, viti 1939, deri të i fundit "Tradhtia"- "Gregori P.K", viti 1954.

Smith thotë se në diskursin narrativ të rëndësishme janë sekuencat, grupi i ngjarjeve të bashkuara në një rend të caktuar, të cilat janë të bashkuara me një temë të unifikuar (Smith, ibid. 2003.:8). Ky tip diskursi, që kompletion diskursin përshkrues, zë vend të rëndësishëm në këtë libër. Gërshetimi i diskurseve bën që ligjërimi i autorit të bëhet autonom dhe, si i tillë, me a pa dashje, reflektues edhe i imagjinatës krijuese. Të gjitha sekuencat rrëfimore reflektojnë pjesë ngjarjesh e përjetimesh të autorit, të cilat në formë mozaiku krijojnë një tërësi tekstore, ndërsa temë unifikuese paraqitet jeta nën regjime të ndryshme, në një kohë dhe vend të caktuar.

Në rrëfimin e parë "Kujtimi i parë-përjetimi i parë" autori pasqyron një sekuencë të jetës në Sarajevë dhe përjetimin e tij të parë tek shihte i ulur para shtëpisë fëmijët duke rrëshqitur. Gjithë rrëfimi pasqyrohet në vetën e parë dhe në kohën e tashme, çka do të thotë se kemi të bëjmë me një diskurs përshkrues.

Shembulli I.

Qëndroj i mbështetur në krahun e derës së madhe prej druri, të shtëpisë sime. Është ngrysje dimërore. Qielli është i mbuluar me re të ndritshme të përhimë. Tregimi "*Kujtimi i parë- përjetimi i parë*", f. 19. Transformimet vetore e kohore nuk mungojnë në rrjedhë të ligjërimin, megjithatë, ato nuk e zhbëjnë veçantinë e diskursit të këtij autori. Më të shpeshta janë transformimet kohore, gjë që nënkupton kalimin nga komenti në rrëfim.

Shembulli II.

Pata fat. Duke punuar, fitova 28 dinarë, të cilat ia dorëzova Dijes. Tashmë rrëfimi ka rrëshqitur në kohë tjetër foljore, në të kryerën e thjeshtë, që është karakteristike për rrë-

fimin. Zëri rrëfyes (autori) sërish mbetet në qendër të rrëfimit, duke u identifikuar kështu përmes formave foljore të kësaj kohe. Ligjërimin në vetën e parë teorikët e konsiderojnë si mundësi optimale të pozicionimit të hapur të rrëfyesit përballë lexuesit. Nga ana tjetër, shikuar në rrafshin lingvistik, kategoria e vizionit lidhet me atë të vetës në atë kuptim që kjo i vë në lojë relacionet që vendosen midis protagonistëve të aktit të ligjëratës (unë e ti) dhe thënies vetë (ai ose ajo). Procesi rrëfimor ka së paku tre protagonistë: personazhin (ai), rrëfyesin (unë) dhe lexuesin (ti)... (Dykro- Todorov, 1984 : 450-451). Në tekstin e Bekim Fehmiut nuk mungon asnjëri prej këtyre tre komponentëve, ndonëse personazhi i personifikuar me përemrin ai del fare rrallë dhe si pjesëtar joaktiv i zhvillimit të ngjarjes. Prandaj, mund të thuhet se teksti i këtij libri është gërshetim i diskursit përshkrues dhe narrativ. Ky gërshetim mund të ilustruhet me përdorimin e formave foljore në tregimin "Familja ime", f. 34-40.

Shembull:

Në këtë tregim përdoren 335 forma foljore. Bazuar në kategorizimin e tekstit në rrëfim dhe koment, frekuenca e përdorimit të formave foljore jep këto shifra: më se e kryera 42, e pakryera 31, e tashmja e lidhore 30, e kryera 9; 185 forma të tjera foljore në të tashmen, 20 në kohën e kryer dhe 8 në kohën e ardhme të dëftores. Proporcioni midis kohëve foljore të komentit dhe rrëfimit është 213 ndaj 112.

4 Kohët foljore

Përcaktimin e kohësisë në tekstin "E shkëlqyeshme dhe e tmerrshme" e kemi bazuar në kategorizimin e kohëve foljore në kohë komentit dhe kohë rrëfimi. Në shqipe kohë foljore të rrëfimit janë: e pakryera, e kryera e thjeshtë, e kryera e tejshkuar dhe ndoshta edhe e tashmja e lidhore, ndërsa kohë të komentit (përfoljes) janë: koha e tashme, koha e kryer dhe koha e ardhme (Ismajli, 1977: 60-61). Në librin "E shkëlqyeshme dhe e tmerrshme" shumica e foljeve dalin në kohën e tashme të mënyrës dëftore, pavarësisht se rrëfimet në tekst janë evokim i ngjarjeve që kanë përfunduar para aktit të të thënit. Kohësia në tekst nuk përputhet me kohët gramatikore. E tashmja mundëson ligjërim dinamik dhe komunikim të drejtpërdrejtë me lexuesin. Përmes kësaj forme foljore autori është gjithnjë në lidhshmëri komunikuese me audiencën, e cila krijon përshtypjen sikur ngjarja është duke ndodhur në çastin e ligjërimin. Në qendër të rrëfimit, madje edhe kur mungon veta e parë, del vetë autori, ndërsa lexuesit i krijohet përshtypja sikur ndodhet para zërit rrëfyes, duke dëgjuar gjithë ato që rrëfen folësi. Në tregimin "Kujtimi i parë-përjetimi i parë", në gjithsej 25 rreshtat e tij, dalin 35 forma foljore. 33 prej tyre janë në kohën e tashme të dëftores, ndërsa 2 të tjera në kohën e pakryer të lidhore. Në këtë tregim, sikur edhe në tregimet e tjera, koha e tashme reflekton neutralitet, sepse parë nga perspektiva folëse, rrëfyesi është indiferent ndaj asaj që thotë.

Shembulli:

U ndezën dritat e rrugës në shtyllat prej drurit. Atje poshtë, shtrihet qyteti. Përmbi pullazet e shpive tymi nga oxhakët luan kaçurrelat e veta mbi bardhësinë e borës... Myezinët prej minareve thërrasin: "All-ahu Ekber" (Zoti është i madh). Tregimi "Kujtimi i parë-përjetimi i parë", f. 20.

Ndërsa, në tregimin "Me rrotë mes këmbëve. Ka Zot", që përbëhet nga 143 rreshta, klasifikimi i kohëve foljeve sipas dendurisë së përdorimit paraqitet me këto shifra: nga 188 forma foljore 141 janë në kohën e tashme të dëftores, 13 në kohën e kryer, 18 në të kryerën e thjeshtë, 9 në kohën e tashme të lidhores, 6 në kohën e ardhme dhe vetëm 1 në kohën e kryer të tejshkuar. E kryera e tejshkuar dhe e kryera në këtë tregim dalin si kohë sfondi. Përlllogaritjet kanë treguar se përqindje të përafërta dalin gati në të gjithë tregimet e këtij teksti. Prandaj, bazuar në hulumtimin e kohëve foljore, të përdorura në këtë libër, mund të konstatojmë se koha e tashme, si kohë dominuese, e bën diskursin e këtij autori komentues (përshkrues). Ky kualifikim përforcohet edhe nga përdorimi i kohës së kryer të dëftores dhe rrallë edhe i së ardhmes. Nga ana tjetër, përdorimi i kohëve të tjera, si: e kryera e thjeshtë, e pakryera dhe koha e tashme e lidhores ndihmojnë në transformimet diskursive të tekstit dhe në krijimin e sfondit të tij. Transformimet kohore ndodhin zakonisht në ligjëratën e drejtë dhe në dialogë. -Nuk e kam ditur që mizat e truallit kundërmojnë, i them Xhevatit. -Çfar' more, ç'far ere t'keqe. Pronari nuk deshti me i shqetsue mizat e trollit mbasi ato bijnë bereqet, - m'u përgjigj Xhevati. Tregimi "**Kokat me vesë**", f. 170. Transformimet e këtylla kohore krijojnë sistem narrativ e përshkrues, por edhe teknikë të posaçme kompozicionale.

5 Tipat e fjalive

Teksti i librit "*E shkëlqyeshme dhe e tmerrshme*" është i ndërtuar mbi bazën e sintaksës popullore. Shquhet për fjali të thjeshta e të shkurtra. Fjalitë e përbëra janë më pak të pranishme. Edhe kur përdoren duken të thjeshta, prandaj si të tilla ruajnë lehtë komunikimin me lexuesin.

Shembull:

Pasi partizanët nuk ia kishin kthyer armët, s'kishte besuar se do ta lëshonin të gjallë, por do ta vrisnin pas shpinës. Tregimi: "Xhandari i liruar...", f. 98. Sintaksën e këtij teksti e bën të veçantë fillimi i fjalive me foljet ndihmëse kam dhe jam, me të cilat zakonisht nis përshkrimi i personazheve dhe i ngjarjeve të rrëfimit. Fjalitë që fillojnë me foljet ndihmëse kam dhe jam shënojnë vetën e tretë njëjës.

Shembull:

Ka flokë të gjata, të zeza. Tenin të natyrshëm, sedefbardhë (f. 37). Ka zë të mrekulueshëm. Hili e adhuron, babai im edhe më tepër (f. 39). Ka sy të sy të mëdhenj të kaltër, të vizatuar përreth... (f. 54). Ka shumë vreshta dhe ara të kollomboçit (f. 93). Është dita e gjashtë që kur mora bërtimën dhe njollën e lirinur në tëmth nga drejtori. (f. 214). Është zotëri shtatlartë, i pashëm, me rroba të mbyllëta (260). Është ora e pestë (287). Duhet shtuar se në tekstin e këtij autori tipat e fjalive dhe rendi i tyre janë mjaft heterogjene. Kjo arsyetohet me faktin se teksti i këtij libri është i ndërtuar nga sekuenca ngjarjesh që "në formë mozaiku" përbëjnë një strukturë, e cila në fund të fundit, duke u ndërtuar mbi praninë e fjalëve referenciale, figurave sintaksore, si: anafora, digresioni, analepsa e ndonjë tjetër, megjithatë krijojnë kohezion dhe vazhdimësi tekstore.

6 Kodet e ligjërit dhe fjalësi

Në shumë sekuenca rrëfimesh në librin "E shkëlqyeshme dhe e tmerrshme" shfaqet dukuria e ndërrimit të kodit nga standardi në dialekt (Code Shifting). Gjithë dialogët, ndonëse numerikisht janë të paktë, zhvillohen në regjistrin formal, në gegërishte, por sërish në vetën e parë dhe në kohën e tashme.

Shembull:

-Unë jam djali i Ibrahim Fehmiut, a asht zotni doktori? Baba asht shumë smutë. Tregimi: "Sytë që më përcjellin....." f. 230. Këto ndërrime ndodhin në ligjëratën e drejtë dhe gjuha e rrëfyesit ose edhe e ndonjë personazhi episodik pasqyron besnikërisht të folurën dialektore, të përzier me elemente të gjuhëve orientale, të qytetit të lindjes së autorit. Karakteristikë tjetër është edhe ndërrimi i kodit në relacionin gjuhë amtare-gjuhë e huaj (Code Sëitching). Këto ndërrime ndodhin në raste habish, urimesh e mallkimesh dhe realizohen në mënyrë të pahetueshme. Ndërrimi i kodit ndodh nga shqipja në turqishte.

Shembull:

Hili edhe disa herë përsërit: "Av-anam, av-anam" (o moj nënë, o moj nënë). Tregimi: "Dimri i parë....", f. 45. Hili vetëm ankohet: "Av-anam, av-anam, patllajxham" (O moj nënë, o moj nënë, do të pëlcase). Tregimi: "Cigarja tarabosh....", f. 90. Hili diçka lllomotit, "allah bela seni versen" (zoti e shtiftë ne bela"). Tregimi: "Këmbët e mavijosura...", f. 92.

Në gjuhën e këtij teksti del mjaft i pranishëm variacioni gjuhësor. Variacioni gjeografik (dialektor) në ligjërimin e folur e të shkruar është më i shpeshti, prandaj edhe më i studiuar. (Bright, 1990: 11).

Shembull:

-Kush këcevi, une? Ti më ndjeke...Ke me pa te drejtori.... Tregimi: Me rrotë mes këmbëve... f. 213. Variacionet, si këto, identifikojnë gjuhën e personazheve, mirëpo shumë fjalë dhe shprehje të përdorura nga autori edhe si variacione dialektore, kur bëhen bashkë me fjalë e shprehje me origjinë orientale, gjuhës së këtij libri i japin kolorit të posaçëm, duke e bërë pasqyruese të ligjërit formal të folësve urbanë. Duhet theksuar se orientalizmat në gjuhën e këtij libri bartin shpesh edhe ngarkesë stilistike. Ato i japin edhe ngjyrim emocional diskursit të tij. Këto fjalë e shprehje përdoren dendur me rastin e përshkrimit të ambienteve dhe të personazheve të librit. Kur jemi te fjalësi i këtij libri, duhet përmendur fakti se autori pasqyron besnikërisht mikrotoponimet e qytetit të tij, që dalin në gjuhën turke, si: Papas-çarshia, Kuri-çeshma, Shadërvani, Islahanja etj. Nga ana tjetër, autori po ashtu përdor shumë fjalë turke për të përshkruar veshjen dhe dukjen e personazheve të rrëfimit. P.sh Dimi allaturka, fustane allafranga, kallçi të leshtë, bakanxhe me thumba etj. Dhe së fundi duhet shtuar se autori përdor fare pak sllavizma. Në këtë rrafsh, bilingualiteti i autorit nuk hetohet fare. Përjashtim bën ndonjë konstrukt fjalie, si p.sh. Gjyshja ime kah nëna...., Nuk vjen në konsiderim dhe ndonjë fjalë e veçuar, që nuk prishin krijimin individual gjuhësor të këtij libri.

7 Përfundime

(1) Libri i Bekim Fehmiut "E shkëlqyeshme dhe e tmerrshme" anon nga kujtimet e shkruara, por në tërësinë e tij nuk mungon gjuha figurative, leksiku relativisht i pasur dhe një tip i veçantë ligjërimi (ligjërimi urban), i cili realizohet nga fjalë karakteristike të qytetit të Prizrenit dhe nga përzierja e tyre në situata të caktuara edhe me fjalë e shprehje orientale. (2) Pjesa qendrore e tekstit është e pasqyruar në vetën e parë dhe në kohën e tashme. Veta e parë e vë autorin në raporte direkte komunikimi me receptuesin e veprës së tij, ndërsa koha e tashme, si kohë komenti, përcakton gjininë e këtij libri. "E shkëlqyeshme dhe e tmerrshme" është një tekst përfolës me një gjuhë didaskalike. (3) Kohët e tjera të foljore të këtij teksti, të cilësuar si kohë rrëfimi, ndihmojnë në transformimin e tekstit nga një tip në tjetrin. Kështu rrëfimi personal rrëshqet në rrëfim impersonal, me ç'rast pasqyrohet edhe imagjinata krijuese e autorit. (4) Gërshetimi i diskurseve bën që ligjërimi i autorit të bëhet autonom dhe, si i tillë, me apo pa dashje, reflekton në nuanca të ndryshme edhe forma të tjera ligjërimi, përtej atij të kujtimeve. (5) Teksti është i ndërtuar nga fjali të shkurtra. Fillimi i fjalive me foljet ndihmëse kam dhe jam gjuhën dhe stilin e autorit e bën të veçantë. (6) Ndërrimet e kodeve ligjërimore pasqyrojnë gjuhën e qytetit të lindjes së autorit me një besnikëri të veçantë. (7) Fjalësi i këtij libri shquhet për përdorim të madh të fjalëve orientale, shpesh me ngarkesë stilistike. (8) Bilingualiteti i autorit nuk hetohet. Gjuha e përdorur në veprën e tij është një shqipe standarde pa fjalë sllave.

Referenca

- Rugova, Bardh Parathënie, në Fehmiu, Bekim (2011).
E shkëlqyeshme dhe e tmerrshme, Koha, Prishtinë.
Hamiti, Sabri (2000), *Bioletra*, Faik Konica, Prishtinë.
Fehmiu, Bekim (2011), *E shkëlqyeshme dhe e tmerrshme*, Koha, Prishtinë.
Carlota S. Smith (2003), *Models of Discourse*, CAMBRIDGE UNIVERSITY PRESS.
Fuko, Miel (2007), *Poredak diskursa*, Zuhra, Beograd.
Dykro - Todorov (1984), *Fjalor enciklopedik i shkencave të ligjërimit*, Prishtinë.
Ismajli, Rexhep (1977), *Shumësia e tekstit*, Rilindja, Prishtinë.
Ëilliam, Bright (1990), *Language variation in South Asia*, OXFORD UNIVERSITY PRESS.